

Më datë 24.01.2022 Departamenti i Auditimit të Performancës i Kontrollit të Lartë të Shtetit zhvilloi analizën për punën e kryer gjatë vitit 2021, në mjediset e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT).

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm: Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), Z. Arben Shehu, Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, Drejtori i Përgjithshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Znj. Marjola Llanaj, Drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, Znj. Aulona Jani, audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës, si edhe përfaqësues të stafit pedagogjik dhe studentë të UBT-së.



Aktiviteti u hap nga Kryetari i KLSH-së, Z. Arben Shehu, i cili në fjalën e tij përshëndetëse falënderoi Rektoren e Universitetit për mikpritjen dhe bashkëpunimin ndërinstytucional, të fokusuar kryesisht në auditimet e performancës. Në vijim të fjalës së tij, Z. Shehu falënderoi audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës për punën e kryer gjatë vitit 2021, vit i cili ka mbartur sfida të shumta për të gjithë, si rezultat i situatës së krijuar nga Pandemia Covid-19. Gjithashtu, Kryetari i KLSH-së vuri theksin në rritjen e kapaciteteve profesionale audituese, dhe ushtrimin e përgjeshmërisë, korrektesës dhe gjykimit profesional të shëndoshë, përgjatë punës audituese, me qëllim rritjen e ndikimit pozitiv në fushat me rëndësi, për mirëqenien e qytetarëve shqiptarë.

Në përshëndetjen e tij, Rektori i Universitetit, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku shprehu mirënjohjen për përzgjedhjen e Universitetit Bujqësor të Tiranës për realizimin e këtij aktiviteti. Ai vlerësoi bashkëpunimin ndërinstytucional dhe u shpreh i gatshëm për intensifikimin e bashkëpunimeve të mëtejshme, në përputhje me kapacitetet universitare.

Në vijim, fjalën e mori Drejtoresha e Departamentit të Auditimit të Performancës, Znj. Aulona Jani, e cila falënderoi edhe njëherë mikpritësit e këtij aktiviteti, si dhe të pranishmit në sallë. Znj. Jani solli në vëmendje se, përzgjedhja e UBT-së për të realizuar këtë aktivitet të rëndësishëm departamental, nuk ishte rastësore, por lidhet ngushtësisht me fushat e përbashkëta të ekspertizës midis Departamentit të Auditimit të Performancës në KLSH dhe UBT-së si, agroturizimin, teknologjinë ushqimore, bujqësinë, mjedisin, etj.

Më tej, Znj. Jani prezantoi treguesit e aktivitetit departamental për vitin 2021. Referuar treguesve, me gjithë situatën e vështirë të krijuar nga Pandemia Covid-19, Departamenti i Auditimit të Performancës e realizoi planin për vitin 2021 në masën 100%, duke kryer 16 auditime nga 16 auditime gjithsej të planifikuara. Përgjatë viti 2021, u audituan 46 subjekte, prej të cilëve rezultuan 447 gjetje, 365 konkluzione dhe 437 rekomandime. Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna në 6 mujorin e parë të vitin 2021, rezultoi se nga 146 masa të lëna, janë pranuar 142 (ose 97.26%), dhe nuk janë pranuar 4 masa (ose 2.74%).

Në prezantimin e saj, Drejtoresha e Departamentit të Auditimit të Performancës u ndal edhe tek bashkëpunimet e departamentit me institucione homologe, duke shprehur rëndësinë e veçante që këto bashkëpunime kanë, për zhvillimin profesional të audituesve të KLSH. Më tej, paraqiti më në detaje *Programin e Trajnimit të SAI-ve të rajonit të Ballkanit Perëndimor*, i cili është një projekt që po zhvillohet nga SAI Suedez për transportin ajror, si dhe auditimin e performancës me temë “*Ndotja e Detit Adriatik*”, i cili u ndërmor paralelisht nga Institucionet Supreme të Auditimit të 6 shteteve që lagen nga deti Adriatik.



Analiza vijoi me prezantimin e tre prej auditimeve të zhvilluara përgjatë vitit 2021, konkretisht: auditimi me temë “*Menaxhimi i mbetjeve plastike*”, që u prezantua nga Kryeaudituesi i Departamentit, Z. Aulent Guri; auditimi me temë “*Efektiviteti i parkimeve të mjeteve motorike në rrugët e qyteteve*” prezantuar nga Znj. Megi Kurushi; “*Performanca e institucioneve rezidenciale të përkujdeset shoqëror për fëmijë*”, prezantuar nga Znj. Xhuljeta Çelaj. Keto prezantime u shoqëruan me pyetje dhe diskutime nga salla.

Në pjesën e katërt dhe të fundit të aktivitetit, Znj. Jani paraqiti objektivat, sfidat dhe pritshmëritë për vitin 2022 dhe ftoi audituesit për të diskutuar mbi to. Në përfundim, Drejtoresha e Departamentit të Auditimit të Performancës, e mbylli diskutimin duke motivuar dhe vendosur theksin tek përkushtimi, serioziteti dhe profesionalizimi i audituesve me qëllim arritjen e objektivave të departamentit për vitin 2022, në funksion të arritjes së objektivave strategjikë të KLSH-së.